



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Prania / Presence Prisence / Presence Prisence / Presence | 02.12.2022 | 2 | viti god year |
| Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKOMSHCK | 7627 | 2022 | 117 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.867/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.867/2022 të datës 05.10.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ në adresë _____ nga Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit/Agjencia e Kosovës për Akreditim, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 02.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.867/2022 e datës 05.10.2022 e parashtruar nga ankuesi .

II. MBETET në fuqi Vendimi numër Nr.1664/22 i datës 03.10.2022 i Komisionit për Vlerësim i Lëvizjes Brenda Kategorisë (KVLBK).

A r s y e t i m

Ankuesi Besart Tasholli, ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, sipas njoftimit të datës 27.07.2022 për aplikim nga data 15.08.2022 deri me datë 29.08.2022, për lëvizje brenda kategorisë në pozitën 'Zyrtar i Lartë për Monitorim dhe Verifikim', për dy (2) pozita të lira, me numër RN00009495, pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të ankuesit, me datë 14.09.2022 është ftuar për intervistë me gojë, për mes sistemit SIMBNJ-së dhe i cili nuk është paraqit para komisionit intervistues edhe pse ka qenë prezent sipas listës së nënshkruar, me arsyetimin se e kundërshton përbërjen e Komisionit për Vlerësim të Lëvizjes Brenda Kategorisë (KVLBK), sepse nuk është në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Me datë 21.09.2022 Agjencia e Kosovës për Akreditim, për mes sistemit SIMBNJ-së, ka publikuar njoftimin përfundimtar, duke njoftuar dhe kandidatet lidhur me rezultatet e arritura të intervistës.

Kundër njoftimit të datës 21.09.2022, ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 26.09.2022 tek Komisioni për Vlerësim të Lëvizjes Brenda Kategorisë (KVLBK), me pretendime ankimore se Komisioni për Vlerësimin të Lëvizjes Brenda Kategorisë (KVLBK), nuk është në pajtim me nenin 46 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse në përbërjen e tij nuk është njëri nga anëtarët Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë siç e përcakton rregullorja.

Komisioni për Vlerësim të Lëvizjes Brenda Kategorisë (KVLBK) me datë 03.10.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.1664/22, me të cilin ankuesit i ka refuzuar ankesën e datës 26.09.2022 si të pa bazuar.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër Nr.1664/22 të datës 03.10.2022 të Komisionit për Vlerësim të Lëvizjes Brenda Kategorisë (KVLBK), me datë 05.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se përbërja e Komisionit për Vlerësim të Lëvizjes Brenda Kategorisë (KVLBK), nuk është në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe se procedura ka shkelje sepse verifikimi paraprak, është bërë vetëm nga Njësia e personelit e jo nga komisioni, nuk është mbajtur testim me shkrim, por vetëm intervistë me gojë, duke propozuar që të anulohet procedura si e kundërligjshme, duke shtuar se nuk është paraqitur para komisionit për intervistë me gojë, për shkak se ka qenë kundër komisionit për vlerësim nga momenti kur ishte në dijeni për përbërjen e komision, duke e përjashtuar zyrtarin ligjor të Autoritetit Kombëtar dhe të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 20.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, ndërsa kjo e fundit me datë 27.10.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 6490/2022 me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, prej 1/58 faqe, si dhe të plotësuar me shkresat e datës 16.11.2022 me numër protokollit 7158/2022 me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5900/2022 të datës 05.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes formës fizike; Vendimi numër Nr.1664/22 i datës 03.10.2022 i Komisionit për Vlerësim të Lëvizjes Brenda Kategorisë (KVLBK); Përgjigje në ankesë e datës 27.10.2022 me numër protokollit 6490/2022 dhe e plotësuar me shkresat e datës 16.11.2022 me numër protokollit 7158/2022; Konkursi i datës 27.07.2022; Lista e aplikantëve e datës 05.09.2022 nga sistemi SIMBNJ-së; CV- Aplikacioni i _____ CV-Aplikacioni i znj. _____; CV-Aplikacioni i _____ CV-Aplikacioni i _____, CV-Aplikacioni _____ CV-Aplikacioni _____ Vendimi me nr. 1171/2022 i datë 06.09.2022 mbi themelimin e komisionit për vlerësim të kandidatëve brenda kategorisë (KVLBK) i nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i AKA-së; E-mail i datës 09.09.2022 njoftim për kandidatin _____, për intervistë me gojë; E-mail i datës 09.09.2022 njoftim për kandidatin znj _____, për intervistë me gojë; E-mail i datës 09.09.2022 njoftim për kandidatin _____ për intervistë me gojë; E-mail i datës 09.09.2022 njoftim për kandidatin _____, për intervistë me gojë; E-mail i datës 09.09.2022 njoftim për kandidatin znj.J.Shala, për intervistet me gojë; E-mail i datës 09.09.2022 njoftim për kandidatin _____ për intervistet me gojë; E-mail i datës 09.09.2022 njoftim për kandidatin _____ për intervistet me gojë; Lista e kandidateve të aprovuar e datës 14.09.2022 me nënshkrime të kandidatëve dhe komisionit; Formulari Individual i Vlerësimit i datës 14.09.2022, prej 1/5 faqe; Formulari i Vlerësimit Përfundimtar për të gjithë Kandidatët i datës

14.09.2022; Rendita Përfundimtare e Kandidatëve e nxjerrë nga sistemi SIMBNJ-së; Vendimi me Nr. 1168/2022 i datë 05.09.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Ankesa e datës 26.09.2022 e ankuesit drejtuar Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes Bredna Kategorisë (KVLBK); Dosja e kandidatëve që kanë aplikuar në konkursin e datës 27.07.2022; Akte emërimi i _____, e datës 01.03.2022; Diplomë Nr.2928 nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Filozofik, për z.F.Pllana, me letërnjoftim; Diplomë Nr.3081 nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Juridik, për z.F.Pllana; Diplomë Master Nr.1483 nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Filozofik, për z.F.Pllana; Certifikatë e datës 21.03.2014; Certifikatën me nr. 15672/2022 e datës 15.07.2022; Vërtetim Nr.35/22 i datës 08.02.2022; Certifikatën e datës 18.03.2022; Certifikatën e datës 13.07.2022; Diplomë Nr.4860 nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Filozofik, për z.L.T.Kelmendi të datës 26.09.2016, me letërnjoftim; Diplomë Master me numër NO.631/21 nga Kolegji "AAB", në Programin Psikologji Organizative dhe Sociologji Prishtinës-Fakulteti Filozofik, për _____ të datës 21.05.2021; Referencë e lëshuar nga kompaninë "Broadcast"; Dëshmi i datës 06.12.2021 për përvojë e lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Malishevë; Diplomë Nr.1944 e datës 30.05.2018 lëshuar nga Universiteti i Tiranës-Fakulteti i Shkencave Sociale; Vendim Nr. Ref.06/402 i datës 19.03.2019 lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Certifikatë e Licencimit me nr.499 e datës 28.02.2022 lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve; Vendim Nr.109 i datës 22.03.2022 lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, për tu pajisur me licencë; Certifikatë e datës 23.11.2018; Certifikatë e Licencimit me nr.499/18 e datës 17.12.2018 lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transferimeve; Vendim Nr.500 i datës 13.12.2018 lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, për tu pajisur me licencë; Certifikatë e datës 02.11.2018; Vërtetim Nr.30/561 i datës 30.06.2017 lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Malishevë; Vërtetim Nr.30/500 i datës 07.04.2022 lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Malishevë; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 28.01.2019; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 29.01.2020, Të bashkangjitur Letërnjoftimi i znj _____ Diplomë nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Filozofik, për znj _____ e datës 30.09.2011, Diplomë-Master lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Filozofik, për znj _____ e datës 14.06.2018; Kontratë e punës e datës 08.06.2012; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 09.01.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 08.01.2021; Certifikatë e datës 26.06.2018; Certifikatë e datës 21.02.2014; Certifikatë e datës 30.01.2014; Certifikatë e datës 23.01.2019; Certifikatë pa datë për znj _____ Certifikatë e datës 03.06.2008; Certifikatë e datës 11.07.2010; Certifikatë pa datë për znj.L.Krasniqi (Osmani); Referencës e datë 25.08.2022 për znj _____ lëshuar nga Policia e Kosovës; Certifikatë nr. 17517/2022 e datës 28.07.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Certifikatë e datës 11.07.2020; Certifikatë e datës 03.06.2008; Certifikatë e datës 03.03.2008; Letërnjoftimi i znj _____; Akt emërimi i datës 01.07.2018; Diplomë Nr.6367 e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Ekonomik, për znj _____ e datës 05.04.2016; Certifikatë e datës 15.04.2021; Diplomë-Master nr.2718 lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Ekonomik, për znj. J.Shala e datës 13.05.2022; Vërtetim i datës 31.03.2022; Vërtetim i datës 30.03.2022; Vendim i datës 19.03.2021; Akt emërimi i datës 01.07.2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 30.11.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 30.01.2022; Letërnjoftim z _____ Akt emërimi i datës 11.10.2019; Diplomë Nr. 4856 e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Juridik, për _____ e datës 27.07.2017; Diplomë - Master Nr.2157 e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Juridik për z. _____ e datës 10.09.2019; Vërtetim i datës 22.08.2022; Certifikatë Nr.3289/2022 e datës 16.08.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Certifikatë nga Janar-qershor 2017; Letër rekomandim lëshuar nga MPMS; Vërtetim i datës 10.09.2016; Certifikatë e datës 28.05.2021; Certifikatë e datës 22.03.2019; Certifikatë e datës 04.05.2018; Certifikatë e datës 005.12.2018; Certifikatë e datës 02.11.2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 13.01.2021; Formularin për vlerësimin e

rezultateve në punë të datës 14.01.2022; Diplomë Master Nr.4 e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti i Shkencave Matematikore-Natyrore, për _____ e datës 12.12.2012, me Vërtetim nga Noteri me numër LRP.nr.2359/2022; Diplomë Nr.270 e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, për _____ e datës 30.11.2006, me Vërtetim nga Noteri me numër LRP.nr.12647/2018; Vërtetim i datës 23.06.2022; Kontratë e punës e datës 02.09.2017; Referencë e datës 23.11.2016; Reference e datës 18.08.2003; Letër rekomandim i datës 04.11.2016; Akt emërimi i datës 28.07.2022; Vërtetim i datës 11.12.2018; Certifikatë Nr.9; Certifikatë e datës 23.11.2021; Formuarin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 29.01.2021; Formuarin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 25.01.2022; Letërnjoftim i znj. _____ Akt emërimi i datës 01.05.2017; Diplomë Nr.1330/13 e lëshuar nga Kolegji "AAB", në Prishtinës-Studime themelore në Program Administratë Publike/Bachelor (BA) në Administratë Publike; ; Diplomë Nr.2070/19-Master e lëshuar nga Kolegji "AAB", Studime Master në Program Administratë Publike dhe Diplomaci në Prishtinës e datës 10.10.2019; Certifikatë MAJ 2004; Certifikatë e datës 19.10.2005; Certifikatë e datës 12.10.2012; Certifikatë e datës 01.10.2012; Certifikatë e datës 07.04.2017; Certifikatë e datës 24.11.2018; Certifikatë e datës 18.05.2016; Letër rekomandim i datës 04.10.2017; Letër rekomandim i datës 11.03.2014; Letër rekomandim i datës 11.03.2014; Letër rekomandim i datës 01.11.2012; Vërtetim i datës 26.02.2021; Formuarin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 25.01.2021; Formuarin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 01.12.2020; Formuarin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 27.01.2022; Letërnjoftim i z. _____, Diplomë Nr.4521 e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Filozofik në Prishtinë për z. _____ i datës 04.05.2016; Diplomë Master Nr.103 e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Filozofik në Prishtinë për _____ i datës 24.12.2012; Akt emërimi i datës 12.04.2013; Certifikatë e datës 07.11.2019; Certifikatë shkurt 2016; kopje nga ligjërata e ndjekur; Certifikatë e datës 01.10.2015; Certifikatë e lëshuar nga Giz; Certifikatë e datës 11.10.2008; Certifikatë e lëshuar nga MASHT; Certifikatë e datës 03.03.2019; Certifikatë mars 2018; Certifikatë pa datë lëshuar nga EU/MASHT; Certifikatë MASHT/IPK 2017; Vendimi datës 01.03.2018; Vendim i datës 09.01.2019; Vërtetim i datës 12.01.2010; Formuarin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 20.12.2017/01.12.2020; Formuarin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 31.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit _____, është e pa bazuar sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit-Agjencia e Kosovës për Akreditim, sipas njoftimit të datës 27.07.2022 ka shpallur konkursin për lëvizje brenda kategorisë për dy (2) pozita të lira te punës 'Zyrtar i Lartë për Monitorim dhe Verifikim', me numër të referencës RN00009495, me afatin për aplikim nga data 15.08.2022 deri me datë 29.08.2022, duke u bazuar në dispozitat e nenit 38 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 40 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Agjencia e Kosovës për Akreditim, me rastin e shpalljes se konkursit të datës 27.07.2022 ka përcaktuar kriteret e përgjithshme formale:

-Arsimi i kërkuar: Diplomë Universitare nga fusha e edukimit, shkencave sociale ose fushave tjera relevante me te paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjte apo vazhdim(specializim)i Diplomës Bachelor), Kualifikime të posaçme formale, Përvoje e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Sipas shkresave të lëndës është konstatuar se në konkursin me numër referencë RN00009495, për dy (2) pozita të lira te punës *'Zyrtar i Lartë për Monitorim dhe Verifikim'*, e shpallur nga Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Agjencia e Kosovës për Akreditim, kanë aplikuar tetë (8) kandidatë, ndërsa vetëm një kandidat është vlerësuar se nuk i plotëson kriteret kurse të gjithë të tjerët në këtë rast edhe ankuesi është vlerësuar se i plotëson kriteret e konkursit i cili me datën 09.09.2022 është njoftuar individualisht përmes emailit zyrtar nga Njësia e Burimeve Njerëzore se ka plotësuar kriteret për listën e shkurte dhe është ftuar për intervistë me gojë me datën 14.09.2022, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se verifikimi paraprak për kandidatet që ka plotësuar kushtet e konkursit është vlerësim i drejtë, rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Kosovës për Akreditim ka vepruar në pajtim me kompetencën e tij të përcaktuar me nenin 44 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 45 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është përcaktuar se: *"1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin"*.

Ankuesi pasi është paraqitur në ditën e intervistës me datë 14.09.2022 është nënshkruar në listën e prezencës respektivisht në „listën e kandidateve të aprovuar”, por që i njëjti nuk është paraqitur për intervistim me gojë respektivisht nuk është përgjigjur përpara Komisionit për Vlerësim të Lëvizjes Brenda Kategorisë (KVLBK), të datës 14.09.2022 me arsyetimin se kundërshton përbërjen e Komisionit për Vlerësim të Lëvizjes Brenda Kategorisë (KVLBK), dhe nuk ka qëndruar në sallë ashtu siç e ka theksuar apo pranuar edhe vete ankuesi në ankesën e parashtruar me datë 05.10.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku ka deklaruar citoj: *"unë këtë radhë nuk jam përgjigjur fare në intervistë kur kamë pa të njëjtit njerëz në komision që kanë qenë herën e kaluar me përjashtime...."pra unë kam marr pjese ne interviste por nuk jam përgjigjur.*

Andaj Kolegji i Këshillit bazuar në deklaratën e ankuesit të parashtruar përmes ankesës së datës 05.10.2022 se: *"unë këtë radhë nuk jam përgjigjur fare në intervistë kur kamë pa të njëjtit njerëz në komision që kanë qenë herën e kaluar me përjashtime"*..., si dhe bazuar në shkresat e lëndës konkretisht „Listën e kandidateve të aprovuar” të datës 14.09.2022, formularët individual të vlerësimit për secilin anëtar të Komisionit, formularin e vlerësimit për të gjithë kandidatet të datës 21.09.2022 dhe formularin për renditjen përfundimtare të kandidateve për pozitën e punës *'Zyrtar i Lartë për Monitorim dhe Verifikim'*, ka konstatuar se pasi që ankuesi nuk është paraqitur në intervistim me gojë respektivisht nuk është përgjigjur përpara Komisionit për Vlerësim të Lëvizjes Brenda Kategorisë (KVLBK), të datës 14.09.2022 por vetëm është nënshkruar në listën e prezencës, dhe sipas përgjigjes në ankesë nga organi i punësimit të datës 26.10.2022 ankuesi nuk ka qëndruar në sallë, Kolegji konstaton se me këtë veprim ankuesi është tërhequr nga procedura konkurruese e filluar me kërkesën e tij me datë 22.08.2022, andaj Kolegji ka konstatuar se tërheqja si e tillë është e përcaktuar në dispozitën ligjore të nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë" dhe 2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë"* sepse në rastin konkret ankuesi në fazën e intervistës me gojë është tërhequr nga procedura e filluar sipas lëvizjes brenda kategorisë, e shpallur në bazë të nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe Komisioni për Vlerësim për Lëvizje Brenda Kategorisë (KVLBK), nuk ka pasur mundësi të bëjë vlerësimin ndaj ankuesit pasi që i njëjti nuk është paraqitur dhe nuk është përgjigjur para komisionit, ashtu siç e përcakton paragrafi 5 dhe 6 i këtij neni ku theksohet se: *"Vlerësimi i kandidateve të*

interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët....6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës.....”, si dhe neni 47 dhe neni 48 i Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se : 1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë. 48 1.Çdo anëtarë i KVLBK jep pikët e tij në mënyrë individuale pas vlerësimit sipas 4 nenit 47 të kësaj rregullore. Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbledhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbledhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurrimit”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka analizuar rrethanat e krijuara ka konstatuar se me mosparaqitjen në intervistën me gojë gjegjësisht mos përgjigjes përpara Komisionit për Vlerësim të Lëvizjes Brenda Kategorisë ankuesi është tërhequr nga konkurrimi dhe të drejtat e tij si kandidat për lëvizje brenda kategorisë për dy (2) pozita 'Zyrtar i Lartë për Monitorim dhe Verifikim', e zhvilluar në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, gjegjësisht ankuesi nuk ka pasur më interes në vazhdimin e konkurrimit për këtë pozitë dhe konsiderohet se e ka braktisur atë, andaj Kolegji konstaton se tërheqja apo braktisja e konkurrimit është e drejtë e ankuesit pasi që ai e ka vlerësuar për të mos vazhduar më tutje në procedurë të konkurrimit në fazën e vlerësimit të intervistës me gojë pranë Komisionit për Vlerësim të Lëvizjes Brenda Kategorisë (KVLBK) dhe i njëjti në Formularin numër protokollit 1382/22 të datës 21.09.2022 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, ankuesi nuk është i vlerësuar në fund të fazës respektivisht të intervistës me gojë.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit se përbërja e Komisionit për Vlerësim të Lëvizjes Brenda Kategorisë (KVLBK), nuk është në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të paqëndrueshme sepse në bazë dëshmive të ofruara konkretisht Vendimit me numër Nr.1171/2022 të datës 06.09.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ka konstatuar se Komisioni për Vlerësim për Lëvizje Brenda Kategorisë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për pozitën 'Zyrtar i Lartë për Monitorim dhe Verifikim', është themeluar në pajtim me nenin 46 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe procedura është zhvilluar në pajtim me nenin 38 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtaret Publikë dhe nenin 40 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe përzgjedhja përfundimtare është bërë në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtaret Publikë. Andaj, Kolegji ka konstatuar se ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë apo interes juridik nga marrëdhënia e tij e punës, apo nuk i është mohuar asnjë e drejtë në këtë procedurë, ashtu siç e përcakton neni 14 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare të datës 21.09.2022 nga procedura e rekrutimit për lëvizje brenda kategorisë, ankuesi nuk ka qenë i vlerësuar në intervistë me gojë për shkak të tërheqjes apo braktisjes së konkurrimit në këtë fazë të procedurës së rekrutimit.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.867/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Kosovës për Akreditim;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.